

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendim i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Kuvendi i Shqipërisë del me deklaratë të përbashkët: Lufta e UÇK-së ishte lufta e një populli për çlirim
ADRESA	https://dosja.al/politike/vendim-i-hages-per-ish-kreret-e-uk-se-kuvendi-i-shqiperise-del-me-dekla-i514652
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:18:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	94eeff20a779b32f95633aca26564e20d53a4156b835b1dd91c9cbcad8ee067b
TEKSTI	8b5cbef9032867c1684818edbe7157dbefdb13a902efe6980f6876c8123a6a52
PAMJA	2eef59d22c17696138b88ebdbb378ecf1b93f036b73de11113d595443276d4cd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9436bb30d05793bf02745978f9e836d084568d83dcc5c68abbad0c91d73bea79
E MËPARSHMJA	b07168bb6e11286ee1f6f461e3f12f3d2b4fa3ba2774cf25272d1b29a7ec33df
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/9436bb30d05793bf02745978f9e836d084568d83dcc5c68abbad0c91d73bea79

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

5 ORE ME PARE

Rrëzohet kërkesa e PD që të mos votohet drafti për pagat e magistratëve, Balla: Hipokrizi! Bardhi: Tërhiqeni ligjin

5 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

20 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

Politike

Vendim i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Kuvendi i Shqipërisë del me deklaratë të përbashkët: Lufta e UÇK-së ishte lufta e një populli për çlirim

Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi theksoi se Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje për të relativizuar krimet e regjimit të Slobodan Millosheviçit. Sipas deklaratës, e vërteta historike për luftën në Kosovë mbetet e palëkundur.



17 Shtator 2026, 15:15
Nga E. D



Niko Peleshi

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

TIRANË- Kuvendi i Shqipërisë ka dalë me një deklaratë të përbashkët pas vendimit të djeshëm të gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, të cilët u dënuan me 81 vite burg total. Në deklaratë, Kuvendi i Shqipërisë shpreh bindjen se lufta e UÇK-së ishte për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi theksoi se Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje për të relativizuar krimet e regjimit të Slobodan Millosheviçit. Sipas deklaratës, e vërteta historike për luftën në Kosovë mbetet e palëkundur.

Në deklaratë thuhet më tej se Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegjitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Në fund të deklaratës, thuhet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj.

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46

"Urime për look-un e ri"/ Muçi
ironizon deputeten socialiste,
Zegjine Çaushti i përgjigjet
ashpër: O psikopat, na hape
barkun

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:22

Me cigare në dorë/ Monika
Kryemadhi bashkëbisedon
me protestuesit para SPAK:
Bashkohuni dhe organizohuni
mes jush!



DEKLARATA E PLOTË:

Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjtën e thellë dhe mosdakordësinë e plotë me një vendim që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kuvendi i Shqipërisë rithekson një të vërtetë historike që nuk mund të relativizohet: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përmdekjes dhe për të fituar të drejtën për të jetuar të lirë në vendin e vet.

Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, dhunës, spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga regjimi i Slobodan Milosheviçit. Pa luftën dhe sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtimit gjakatar serb, historia e çlirimit të Kosovës nuk mund të kuptohet. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës dhe e rugës që çoi drejt çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së saj. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj.

Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën. Nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së. Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për standardet e dyfishta në trajtimin e së kaluarës së përgjakshme të rajonit. Nderimet publike dhe shtetërore që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte, si edhe glorifikimi i figurave të lidhura me gjenocidin dhe spastrimin etnik, përfshirë Ratko Mladiçin, cenojnë kujtesën e viktimave, pengojnë pajtimin dhe bien ndesh me vlerat europiane.

Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën, popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre.

E palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që: Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat. Të koordinojë veprimet me Kuvendin e Kosovës, dhe i bën thirrje të dyja Qeverive tona që gjithashtu të koordinojnë veprimet, me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rugë institucionale./Dosja.al

niko peleshi

Sondazh

Poll



AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 10:41

“Ramoviç jep dorëheqjen sa më parë!”/ Vijon protesta pranë Kuvendit, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama (VIDEO)

më të klikuarat

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro



Të shtënëat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasi/ Eno Agasi zhduku verën miliona euro nga kantina djalit të xhaxhait

“Dënimi i Thaçit është skandaloz”/ Richard Grenell kërkon mbylljen e Gjykatës Speciale: Kurti të veprojë menjëherë

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow

Politike

17 Shtator 2026, 14:46

"Evis Sala ka qenë studiuese e rrallë"/ Berisha lavdëron ish-Ministren, thirrje Spahiut: Shko e pi kafe me Karçanajn të mbledhësh mendjen!

Sali Berisha TIRANË- Lideri i PD-së, Sali Berisha i kërkoi ministres së Shëndetësisë Klodiana Spahiu të japë d...

"KAYO skandal i paparë"/ Berisha: Bëhet trafik armësh, e shëmtuar për një vend të NATO-s

Politike

17 Shtator 2026, 14:42

Kërkoi pezullimin e afateve të paraburgimit, rrëzohet kërkesa për lirin e Ilir Metës

Politike

17 Shtator 2026, 14:41

"E qepi gojën"! Berisha për Ramën pas vendimit të Hagës: I futi thikën pas shpine Kosovës

Politike

17 Shtator 2026, 14:35

"O e sjell PET Scan-in, o jap dorëheqjen"/ Spahiu bën premtimin në Kuvend: Në janar 2027 do të jetë në Onkologjik

Politike

17 Shtator 2026, 13:33

Politike

17 Shtator 2026, 13:07

Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, Haga hap procedurën për dëmshpërblimin e viktimave

HAGË- Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë vendosur të zhvillojnë procedurën për zhdëmtimin e viktimave në...

Boçi: Shkollat me më pak se 21 nxënës u përjashtuan nga PISA 2025. Kumbaro: Përzgjedhja e shkollave sipas metodologjisë së OECD-së

Politike

17 Shtator 2026, 12:54

Berisha: Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë

Politike

17 Shtator 2026, 12:43



Berisha në Kuvend: Jeni bërë ushtarë të Padronit dhe Yeffet-it, po i jepni paratë kompanisë së Edi Ramës

Politike


17 Shtator 2026, 12:30

"Urime për look-un e ri"/ Muçi ironizon deputeten socialiste, Zegjine Çaushi i përgjigjet ashpër: O psikopat, na hape barkun

Politike

17 Shtator 2026, 11:46

MË SHUMË





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.